

# Shtëpia në Finlandë

INFORMATATA PËR EMIGRANTË MBI BANIMIN, STUDIMIN  
DHE MBROJTJEN SOCIALE



**TYÖMINISTERIÖ**

## PASQYRA E LËNDËS:

<b>HYRJE</b> .....	<b>3</b>
PLANI I INTEGRIMIT?.....	3
E DREJTA PËR MBROJTJE SOCIALE.....	3
<b>1. SI EMIGRANT NË FINLANDË</b> .....	<b>4</b>
MUND TË KËRKONI PËRKTHYES.....	4
MËSIMI I GJUHËS.....	4
GRATË DHE BURRAT SHKOJNË NË PUNË.....	4
SHËRBIMET E ENTIT TË PUNËSIMIT.....	4
NJERËZ TË RINJ, ZAKONE TË TJERA JETE.....	5
<b>2. KOMUNA DHE BANIMI</b> .....	<b>5</b>
TË DREJTAT E QYTETARIT.....	6
BANIMI – NË SHTËPI PRIVATE APO NË SHTËPI ME QIRA.....	6
• <i>Banesa me qira</i> .....	6
• <i>Kontrata e qirasë</i> .....	6
<b>3. MBROJTJA SOCIALE E VARUR NGA BANIMI DHE MBROJTJA TË TJERA SOCIALE</b> .....	<b>6</b>
LEVERDITË E KELAS.....	7
• <i>Të holla ditore të pushimit mjekësor</i> .....	8
• <i>Kompensimet e ilaçeve</i> .....	8
• <i>Asistenca e qirasë</i> .....	8
KUJDESI SHËNDETËSOR NË PUNË.....	8
LEVERDITË E PAPUNËSISË.....	8
• <i>Të hollat ditore të papunësisë</i> .....	8
• <i>Asistenca e tregut të punës</i> .....	9
• <i>Të hollat ditore të papunësisë të varura nga rroga</i> .....	9
PENSIONET.....	9
• <i>Pensioni popullor</i> .....	9
• <i>Pensioni i punës</i> .....	10
ASISTENCA E VEÇANTË PËR EMIGRANTË.....	10
NDIHMA ELEMENTARE.....	10
POZITA DHE TË DREJTAT E KLIENTIT TË KUJDESIT SOCIAL.....	10
AVOKATI PËR ÇËSHTJET SOCIALE.....	10
<b>4. PUSHIMET FAMILJARE TË KUJDESIT PËR FËMIJËN</b> .....	<b>11</b>
PUSHIMI AMËSOR.....	11
PUSHIMI ATËROR.....	11
PUSHIMI PRINDËROR.....	11
PUSHIMI PËR KUJDESI E FËMIJËS.....	11
SHITESAT E FËMIJËVE.....	12
NDIHMA AMËSORE.....	12
<b>5. KUJDESI DITOR DHE EDUKIMI I HERSHËM I FËMIJËVE</b> .....	<b>12</b>
ÇERDHE APO KUJDESI DITOR FAMILJAR?.....	12
PARQET ZBAVITËSE.....	12
ÇERDHET E HAPURA.....	13
KUJDESI DITOR PËR FËMIJËN GJATË SHKOLLIMIT TË EMIGRANTIT.....	13
KËRKESA PËR KUJDESI DITOR.....	13
PAGESAT E KUJDESIT DITOR.....	13
MËSIMI PARASHKOLLOR PARA FILLIMIT TË SHKOLLËS.....	13
AKTIVITETET E LIRA PËR TË RINJ.....	13

<b>6. NGA MARTESA NË DIVORC</b> .....	<b>13</b>
ALIMENTACIONI .....	14
SUBVENCIONI .....	14
<b>7. SHKOLLIMI DHE MËSIMI</b> .....	<b>14</b>
SHKOLLA FILLORE .....	14
• <i>Ushqimi</i> .....	14
• <i>Mësimi fetar</i> .....	14
GJIMNAZI DHE INSTITUTET SHKOLLORE PROFESIONALE.....	14
SHKOLLIMI I INTEGRIMIT .....	15
SHKOLLAT E LARTA, SHKOLLAT E LARTA PROFESIONALE DHE UNIVERSITETET .....	15
SHKOLLAT POPULLORE.....	15
INSTITUTET POPULLORE DHE INSTITUTET E PUNËTORËVE .....	15
BURSA PËR STUDIM.....	16
BURSA PËR SHKOLLIM .....	16
<b>8. KUJDESI SHËNDETËSOR</b> .....	<b>16</b>
QENDRAT SHËNDETËSORE .....	16
KËSHILLIMORET PËR NËNA .....	16
KËSHILLIMORET PËR FËMIJË .....	17
KUJDESI SHËNDETËSOR NË SHKOLLË .....	17
KUJDESI SHËNDETËSOR PËR TË SËMURIN .....	17
KUJDESI SHËNDETËSOR PRIVAT .....	17
ILAÇET.....	18
TË DREJTAT E PACIENTIT .....	18
<b>9. SHËRBIMET PËR INVALIDË</b> .....	<b>18</b>
ASISTENCA E KELAS PËR INVALIDË DHE TË SËMURË KRONIKË.....	18
• <i>Të hollat e kujdesit të veçantë për prindërit e fëmijës</i> .....	18
• <i>Asistenca për fëmijën e sëmurë ose invalid</i> .....	19
• <i>Asistenca për invalidë</i> .....	19
• <i>Rehabilitimi</i> .....	19
<b>10. SHËRBIMET PËR TË MOSHUARIT</b> .....	<b>19</b>
SHËRBIMET NË SHTËPI .....	19
BANESAT PËR TË MOSHUAR DHE SHTËPITË E PLEQVE.....	19
<b>11. SI FINANCOHET MBROJTJA SOCIAL?</b> .....	<b>20</b>
<b>12. NGA MUND TË MERRET NDIHMË NËSE KENI PROBLEM?</b> .....	<b>20</b>
NUMRAT E RËNDËSISHËM TË TELEFONIT.....	20
URGJENCA .....	20
SHËRBIMET PËR SËMUNDJE MENDORE DHE SHËRBIMET PËR KRIZA .....	20
ZYRAT E SËMUNDJEVE MENDORE DHE KËSHILLIMORET PËR FAMILJE .....	20
SHTËPITË E STREHIMIT.....	21
KLINIKAT A.....	22
NDIHMA LEGALE .....	22
ZYRA E PËRFAQËSUESIT TË MINORITETEVE.....	22
ZYRA E KËSHILLAVE JURIDIKE PËR REFUGJATË.....	22
AVOKATËT PRIVATË .....	22
KËRKIMI NDËRKOMBËTAR I PERSONIT .....	23
ADRESA INTERNETORE TË DOBISHME .....	23

## Hyrje

Mirësevini në Finlandë! Në këtë udhëzues flitet për jetesën dhe aktivitete të tjera në Finlandë, si banimi dhe shkollimi. Në udhëzues janë paraqitur në mënyrë të ngjeshur shërbimet publike më të rëndësishme dhe leverditë sociale në faza të ndryshme të jetës.

Emigrantë konsiderohen refugjatët, emigrantët për punë, personë të riatdhesuar si dhe të huaj të tjerë. Emigranti merr shërbime dhe leverdi sociale të cilët lehtësojnë jetesën në një ambient të ri. Të drejtat dhe detyrat e emigrantit varen nga cili vend ka emigruar ai, nga Europa e Bashkuar, nga Zona Ekonomike e Europës apo nga vende të tjera. Me anë të shërbimeve synohet që emigranti t'i përshtates jetesës në Finlandë dhe që ai të ketë njohuri dhe aftësi të nevojshme për një jetesë normale në Finlandë.

Entet e punësimeve mund t'ju ndihmojnë në çështjet e punës. Në entet e punësimeve do të gjeni dhe shërbimet e punëdhënësve: [www.mol.fi](http://www.mol.fi). Informata për atdheun e ri mund të gjeni në adresën [www.suomi.fi](http://www.suomi.fi)

### Plani i integrimit?

*Me plan të integrimit nënkuptohet që emigranti të fitojë njohuri dhe aftësi me ndihmën e të cilave ai të mund të mbijetojë në atdheun e ri, si dhe të mund të marrë pjesë në jetën e punës dhe aktivitetet shoqërore si anëtar me të drejta të barabarta.*

Ligji i integrimit ka lehtësuar mundësinë e emigrantit për të patur të drejta të barabarta në shoqërinë finlandeze (Ligji hyri në fuqi më 1.5.1999). Emigrantët kanë të drejtë për tu përfshirë në planin e integrimit nëse janë shpërngulur në Finlandë pas 1.5.1997, janë me banim të përhershëm në Finlandë, janë të regjistruar si punëtorë të papunë dhe/ose marrin ndihmë elementare. Afati maksimal i planit të integrimit është tre vjet. Në këtë plan mund të merret vesh për mënyrën se si do të mësojë emigranti bazat e gjuhës finlandeze, ose suedeze dhe njohuritë themelore të shoqërisë. Qëllimi i planit të integrimit është lehtësimi i integrimit të emigrantit në Finlandë.

Informata të mëtejshme: [www.mol.fi](http://www.mol.fi)

### E drejta për mbrojtje sociale

Personi që shpërngulet në Finlandë ka të drejtë për mbrojtje sociale e varur nga banimi që prej kohës së mbërritjes në Finlandë, në qoftë se ai ka si qëllim të banojë përherë këtu, si dhe nëse ai ka lejeqëndrim njëvjeçar (në rast se lejeqëndrimi kërkohet si kusht).

Shpërngulja konsiderohet si e përhershme kur personi vjen në Finlandë si i riatdhesuar, si refugjat, ose kur azilkërkuesit i miratohet leje-qëndrimi me afat jo më pak se një vit. Gjithashtu, banimi konsiderohet si i përhershëm edhe kur shpërngulja ndodh për shkak të shkaqeve familjare, ose kur personi ka marrëdhënie të përhershme pune në Finlandë, ose kur marrëdhënia e punës këtu zgjat jo më pak se dy vjet. Natyrisht, nga emigranti kërkohet që ai të jetojë konkretisht këtu. Personat që vijnë në Finlandë për pak kohë, zakonisht, nuk konsiderohen që janë me banim të përhershëm, kështu që ata nuk kanë të drejtë për mbrojtjen e ofruar nga Enti Popullor për Sigurimin Shëndetësor dhe Pensional (Kela).

Informata të mëtejshme: [www.kela.fi](http://www.kela.fi)

## 1. Si emigrant në Finlandë

Integrimi i emigrantëve në shoqërinë finlandeze përkrahet dhe lehtësohet në mënyra të ndryshme. Në Finlandë ka 446 komuna. Secili person që shpërngulet me banim të përhershëm në Finlandë do të jetë banor i një komune. Komuna është zona e përbërë nga një ose më shumë fshatra, ku kryhen punët e përbashkëta. Edhe qytetet janë komuna. Të gjithë banorët e komunës kanë, kryesisht, të njëjtat të drejta dhe detyra. Në shumë komuna ka seksione, ose punëtorë të specializuar për emigrantë nga të cilët mund të merrni këshilla dhe udhëzime. Në shumë qytete ka një vend ndërkombëtar takimi, ku emigrantët dhe finlandezët mund të njihen me njëri-tjetrin, të shkëmbejnë eksperiencën dhe të zbavitën me aktivitete të lira.

### Mund të kërkontë përkthyes

Në rast se nuk ju mjafton niveli i gjuhës gjatë kryerjes së çështjeve tuaja zyrtare mund të kërkontë përkthyes nga autoritetet zyrtare. Për të patur përkthyes duhet të lajmëroni paraprakisht autoritetet zyrtare. Ata rezervojnë përkthyesin. Është e rëndësishme që klienti të jetë vetë i pranishëm në kohën e caktuar. Ndhimën e përkthyesit mund ta kërkontë edhe në entet e punësimit. Detyra e përkthyesit është thjeshtë të përkthejë, pra të transmetojë të folurën nga njëra gjuhë në tjetrën. Përkthyesi është nën obligimin e ruajtjes së sekretit zyrtar.

### Mësimi i gjuhës

Mësimi i gjuhës së vendit ndihmon në integrimin dhe në situatat e jetës së përditshme. Në Finlandë ka dy gjuhë zyrtare, finlandishtja dhe suedishtja. Në punë, njohuria e gjuhës finlandeze është e domosdoshme. Emigrantët në moshë të rritur mund të mësojnë gjuhë në qendrat e shkollimit për të rritur, në gjimnazet për të rritur, në institute popullore, institute të punëtorëve, si dhe në katedrat gjuhësore të universiteteve dhe të shkollave të larta. Informata të mëtejshme për kurset e gjuhës mund të merrni nga entet e punësimit.

Informacione mund të gjeni dhe në faqet internetore të instituteve shkollore dhe nga faqja internetore e Ministrisë së Punës [www.oph.fi](http://www.oph.fi)

### Gratë dhe burrat shkojnë në punë

Në Finlandë gratë dhe burrat kanë, në parim, mundësi të njëjta për të ndjekur një profesion ose për punësim. Zakonisht, gratë punojnë jashtë shtëpisë. Në rast se gjetja e punës është e vështirë, atëherë mund të njiheni me aktivitetet për të papunët. Entet e punësimit ndihmojnë në gjetjen e punës dhe shkollimit. Mund të informohesh dhe për mundësinë e hapjes së tregtisë private. Edhe punëdhënësit mund të vijnë për punë zyrtare në entet e punësimit. Firmat tregtare të emigrantëve marrin mbështetje financiare me të njëjtat kushte si edhe firmat tregtare finlandeze. Shteti finlandez ka kompaninë e vet të financimit Finnvera Oyj. Ajo përkrah themelimin e aktivitetit tregtar duke dalë garant dhe duke miratuar garanci eksporti.

Informata të mëtejshme: [www.finnvera.fi](http://www.finnvera.fi)

### Shërbimet e entit të punësimit

Entet e punësimit janë organe të mirëmbajtura nga shteti të cilat ndihmojnë, për shembull, në kërkimin e punës dhe në punësim, në mundësimin e asistencës për të papunët, në zgjedhjen e profesionit dhe në çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin e karrierës, marrjen e shkollimit dhe fillimin e aktivitetit tregtar. Në një pjesë të enteve të punësimit ka nëpunës të specializuar për emigrantë. Edhe informata edhe për lejet e punës merren në entin e punësimit. Të gjitha shërbimet e entit të punësimit janë pa pagesë.

Punëdhënësit lajmërojnë në entin e punësimit një numër të konsiderueshëm të vendeve të lira të punës. Përveç entit të punësimit, vende pune mund të kërkohen dhe përmes kanaleve të tjera, si me anë të njoftimeve në gazetë dhe duke kontaktuar drejtpërdrejt punëdhënësin.

Në përdorim ka si shërbime personale të këshilltarit për punësim, ashtu edhe vetëshërbim. Në ndërmjetësimin e punës mund të regjistroheni si punëkërkues edhe nëse jeni i punësuar ose i papunë. Për të marrë asistencën e papunësisë duhet patjetër të regjistrohesh si punëkërkues. Personit që regjistrohet si punëkërkues i mundësohet ndihma profesioniste e këshilltarit të punës në procesin e gjetjes së punës. Në rast se punëkërkuesi e sheh të nevojshme përmirësimin e përgatitjes së tij, atëhere ai mund të drejtohet në kurset e organizuara nga enti i punësimit.

Gjithashtu, Linja e Punës (Työlinja) shërben si mjet ndihmës i punëkërkuesit. Mund të telefononi në linjën e punës e hënë – e premte, ora 8.00 – 19.00, me tarifë të thirrjes lokale në të gjithë vendin (8,21 cent/telefonatë + 1,47 cent/min, nga telefoni i dorës 29,26 cent/min). Këshilltarët e Linjës së Punës shërbejnë dhe këshillojnë personalisht në numrin tonë të shërbimit 0203 66066, 0203 66022, 0203 66077 dhe 0203 60011.

Pyetje të ndryshme lidhur me shërbimet e entit të punësimit dhe faqen internetore të ministrisë së punës [www.mol.fi](http://www.mol.fi) mund t'i dërgoni dhe në postën internetore [tyolinja@mol.fi](mailto:tyolinja@mol.fi)

### **Njerëz të rinj, zakone të tjera jete**

Mënyra më e natyrshme për tu njohur me zakonet e jetës të vendit ku banohet është takimi me njerëz të tjerë. Mund të lidhni kontakte me finlandezët që jetojnë afër, pse jo në oborrin e pallatit ku banoni, ose në vende ku kryeni aktivitetet e lira, si për shembull në shoqëri sportive dhe në ambjente shkollore. Gjithashtu shoqata të ndryshme mund të organizojnë aktivitete shoqërore dhe të lira në vendbanimet tuaja. Bashkë me nënën dhe babën duhet të merrni pjesë në aktivitetet për prindër të organizuara nga çerdhet dhe shkollat.

Familja, fisi dhe miqtë janë mbështetja më e mirë për emigrantin në një ambjent të ri. Kur jeton larg atdheut e vë re shpejt se sa e rëndësishme është gjuha amtare, kultura dhe tradita, ushqimi, muzika dhe vizitat sociale të ndërsjellta.

Në shumë komuna ka bashkime dhe shoqata miqësie të emigrantëve. Kryqi i Kuq i Finlandës (SPR) ndihmon në rast nevojë në gjetjen e personit, ose familjes mike. Shokët dhe familje të tilla kanë dëshirë të njihen me refugjatë dhe emigrantë dhe t'i ndihmojnë atyre në fillimin e jetës së re.

Informata të mëtejshme [www.redcross.fi](http://www.redcross.fi)

## **2. Komuna dhe banimi**

Secili emigrant me banim të përhershëm në Finlandë është anëtar i një komune, pasi ai të jetë regjistruar si banor i përhershëm në regjistrin e popullsisë. Për këtë të fundit duhet bërë regjistrimi i shërnguljes në zyrën e gjendjes civile.

Informata të mëtejshme për regjistrimin mund të merrni nga zyra e gjendjes civile, adresa e të cilave gjendet në librin telefonik të komunës përkatëse në seksionin e zyrës së gjendjes civile.

Regjistrimi i shpërnguljes mund të bëhet edhe me telefon 0203 456 456 (në finlandisht), ose 0203 457 457 (në suedisht) dhe në internet në adresën [www.vaastorekisterikeskus.fi](http://www.vaastorekisterikeskus.fi), ose në postë [www.posti.fi](http://www.posti.fi)

### **Të drejtat e qytetarit**

Secili nënshtetas finlandez i cili ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç ka të drejtë të votojë në zgjedhjet shtetërore dhe në referendum. Secili nënshtetas finlandez dhe secili i huaj me banim të përhershëm në Finlandë, i cili ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç ka të drejtë të votojë në zgjedhjet komunale dhe referendimet e komunës.

Për informata të mëtejshme: [www.finlex.fi](http://www.finlex.fi)

Në Finlandë parlamenti, presidenti i republikës, kryesitë e komunave dhe (16) anëtarët e parlamentit europian zgjidhen me anë të zgjedhjeve të përgjithshme.

Për informata të mëtejshme: [www.suomi.fi](http://www.suomi.fi)

### **Banimi – në shtëpi private apo në shtëpi me qira**

Pjesa më e madhe e finlandezëve jeton në shtëpi private për të cilat ata marrin borxh. Borxhi merret zakonisht nga banka dhe për të pagohet interes. Mund të kërkonit prej bankave oferta lidhur me kohëzgjatjen dhe shlyerjen e borxhit.

- **Banesa me qira**

Janë autoritetet zyrtare ato që i sigurojnë refugjatëve dhe një pjese të emigrantëve banesën e parë me qira. Pas kësaj banesa kërkohet vetë.

Përveç komunave, banesa me qira ofrojnë edhe kompanitë e sigurimeve, komunitete kishtarë, si dhe fondacione e komunitete të ndryshme. Banesa me qira për studentët ofrohen nga fondacionet e studentëve. Banesa me qira mund të sigurohet edhe nëpërmjet një personi privat, ose përmes ndërmjetësit. Në këtë rast, zakonisht, pagohet një shumë të hollash si garanci, ose parapagim. Ndërmjetësit i pagohet përqindja e ndërmjetësimi.

Kur shpërngulesh në një banesë të re është mirë të njihesh me rregulloren. Në të flitet për udhëzime dhe rregulla të përgjithshme.

- **Kontrata e qirasë**

Qiramarrësi lidh kontratë qiraje me pronarin e banesës. Në kontratë përcaktohet shuma e qirasë dhe mënyra e pagesës. Zakonisht, qiraja pagohet paraprakisht në fillim të muajit. Në kontratë shënohet për sa kohë do të zgjasë marrja me qira e banesës. Kontrata mund të hartohet e tillë që të jetë në fuqi pa kufi kohe. Në rast se qiraja nuk pagohet në kohë, ose qiraxhiu shqetëson të tjerët, qiradhënësi mund ta ndërpresë kontratën e qirasë. Në këtë rast qiraxhiu duhet të largohet nga banesa. Kontrata e banesës mund të prishet edhe menjëherë. Ligji i marrjes me qira të banesave përcakton rregullat e qiramarrjes. Në rast problemi legale mund të merrni ndihmë nga zyra e ndihmës legale pranë komunës.

## **3. Mbrojtja sociale e varur nga banimi dhe mbrojtja të tjera sociale**

Mbrojtja sociale e bazuar në ligjin finlandez ndahet në mbrojtjen sociale të varur nga banimi dhe mbrojtje sociale të varur nga puna.

Mbrojtja sociale e varur nga banimi përfshin sigurimin minimal të pensionit dhe sigurimin elementar në rast sëmundje dhe papunësie, si dhe mbështetjen financiare për familjet që kanë shpenzime të fëmijëve. Pjesa më e madhe e mbrojtjes sociale finlandeze janë mbrojtje sociale të varura nga banimi: leverditë i paguhen thuajse vetëm personave që banojnë në Finlandë. Në tërësi,

mbrojtja sociale e varur nga banimi përfshin mbrojtjen sociale të administruar nga Kela, shërbimet komunale sociale dhe shëndetësore, sigurimet e papunësisë të administruara nga arkat e papunësisë, si dhe sigurimi shëndetësor i paguar nga arkat e vendeve të punës.

E drejta për asistencë sociale mund të lind edhe në bazë të marrëveshjeve, ose urdhëresave ndërkombëtare. Të tilla janë legjislacioni i bashkësisë evropiane për mbrojtjen sociale si dhe marrëveshjet mbi mbrojtjet sociale. Në përshtatjen e legjislaturës ndërkombëtare është vendimtar vendi se ku punon personi – jo ku ai banon. Informata më të hollësishme mbi legjislaturën e BE:së dhe marrëveshjet e mbrojtjes sociale si dhe për ndikimin e tyre në mbrojtjes sociale mund të merrni nga zyrat e Kelas.

Në pranimin e mbrojtjes sociale të administruar nga Kela, personi konsiderohet se banon në Finlandë, nëse ai ka këtu banesë dhe shtëpi, si dhe nëse ai jeton kryesisht këtu.

Për të marrë mbrojtjen sociale të varur nga banimi duhet plotësuar formulari Y77, që merret nga Kela. Formulari dorëzohet në zyrën e Kelas në komunën e banimit të kërkuesit. Më pas kërkuesi merr nga Kela një vendim me shkrim me të drejtë apelimi. Nëse vendimi është pozitiv, kërkuesit i dërgohet edhe karta e Kelas. Leverdi të veçanta mund të kërkohen me anë të formularëve përkatës.

Nëse personi konsiderohet se është me banim të përhershëm në Finlandë, ai ka të drejtë të kërkojë leverdi të administruara nga Kela, njësoj si banorët e tjerë:

- ❖ shtesat e fëmijëve
- ❖ ndihma amësore
- ❖ të hollat ditore të pushimit mjekësor
- ❖ të hollat ditore prindërore
- ❖ kompensimet mjekësore të sigurimit shëndetësor
- ❖ të hollat ditore të papunësisë dhe asistencë e tregut të punës
- ❖ asistencë e kujdesit për fëmijë
- ❖ asistencë invalidore
- ❖ rehabilitimi i organizuar nga Kela dhe të holla për rehabilitim
- ❖ pensioni popullor dhe pensioni familjar
- ❖ asistencë e qirasë për pensionistin dhe asistencë e përgjithshme e qirasë
- ❖ asistencë e kujdesit shtëpiak dhe kujdesit privat të fëmijëve
- ❖ asistencë për udhëtimin në shkollë

Informata të mëtejshme: [www.kela.fi](http://www.kela.fi)

Mbrojtja sociale e punës përfshin pensionet të varura nga rroga, sigurimin në rast aksidenti, si dhe sigurimin në rast aksidenti në punë, ose në rast sëmundje profesionale. Mbrojtjet sociale të varura nga përvoja në punë administrohen nga kompani private sigurimesh dhe Qendra e Sigurimit Pensionsal.

### **Leverditë e Kelas**

Të gjithë personët me banim të përhershëm në Finlandë bëjnë pjesë në rrethin e sigurimit shëndetësor. Kela kompenson një pjesë të shpenzimeve të vizitave në mjekët privatë, të ekzaminimeve në institucione mjekësore privatë dhe të ilaçeve. Gjithashtu, ata që bëjnë pjesë në sistemin e sigurimit shëndetësor kanë të drejtë të marrin të holla ditore të pushimit mjekësor, si dhe të holla amësore, atërore dhe prindërore.

- **Të holla ditore të pushimit mjekësor**

Nëse mjeku konstaton se punëtori (i moshës 16-64 vjeç) do të jetë i paafte për punë për një periudhë më të gjatë kohe, atëhere atij i paguhen të holla ditore të pushimit mjekësor për aq kohë sa të jetë i sëmurë.

Koha e vetëpërgjegjesisë për të cilën nuk paguhen të holla ditore është rreth dy javë (nga dita e fillimit të sëmundjes dhe nëntë ditë pune në vijim). Shuma e të hollave ditore të pushimit mjekësor llogaritet në bazë të të ardhurave dhe ajo është e tatimuar. Të hollat ditore paguhen për jo më shumë se 300 ditë.

Nëse i sëmuri nuk ka të ardhura, ose të ardhurat janë shumë të vogla, atëhere atij mund t'i paguhet shuma minimale e të hollave ditore, në qoftë se sëmundja ka vazhduar për më shumë se 55 ditë.

- **Kompensimet e ilaçeve**

Ilaçet shiten në barnatore. Një pjesë e ilaçeve kanë nevojë për recetë nga mjeku, një pjesë jo. Sigurimi i shëndetit, pra Kela, kompenson një pjesë çmimit të ilaçeve të rekomanduara nga mjeku. Disa ilaçe të sëmundjeve të rënda kompensohen thuajse tërësisht.

- **Asistenca e qirasë**

Kela i paguan personave me të ardhura të vogla asistencë qiraje, në përcaktimin e së cilës influencojnë, midis të tjerash, madhësia e familjes, të ardhurat familjare, shpenzimet e banesës dhe madhësia e banesës. Për pensionistë ka asistencë qiraje të veçantë, ndërsa për studentët shtesë banesore. Kushtet e banimit të studentit dhe marrëdhëniet familjare janë faktorët kryesorë që influencojnë në marrjen e shtesës banesore, apo të asistencës së qirasë së përgjithshme nga ana e studentit.

### **Kujdesi shëndetësor në punë**

Punëdhënësit sigurojnë shërbime shëndetësore për punëtorët e tyre. Informata të mëtejshme për kujdesin shëndetësor në punë mund të merrni nga punëdhënësi juaj.

### **Sigurimi në rast aksidenti**

Të gjithë punëdhënësit janë të detyruar të marrin sigurime në rast aksidenti për punëtorët e tyre. Kjo kompenson humbjen e përfitimeve të shkaktuara nga aksidenti në punë dhe sëmundja profesionale, si dhe kompenson shpenzimet e mjekimeve të ndryshme. Në rast vdekje personave të afërt të familjes i paguhet pension familjar dhe ndihmë financiare për shërbimet e funeralit.

### **Leverditë e papunësisë**

Në rast se mbeteni i papunë, ose mbaroni studimet dhe nuk keni vend pune, atëhere është e arsyeshme të regjistroheni si punëkërkuar në zyrën e entit të punësimit. Regjistrimi në entin e punësimit është kusht për marrjen e leverdive të papunësisë. Edhe koha e vetëpërgjegjesisë, për të cilën nuk paguhen leverdi papunësie, zakonisht fillon prej kohës kur bëhet regjistrimi në entin e papunësisë. Kela paguan sigurimin elementar të personit të papunë. Të hollat ditore të papunësisë me bazë rroge, pra të varuara nga rroga, i paguhen anëtarëve nga arka e papunësisë.

- **Të hollat ditore të papunësisë**

Punëkërkuari i regjistruar si i papunë mund të marrë prej Kelas të holla ditore për papunësi, në qoftë se ai ka qenë në punë me pagesë për dhjetë muaj gjatë dy vjet e katër muajve të fundit (njëzetetë muaj), ose në rast se ai ka qenë i punësuar si ndërmarrës privat për dy vjet gjatë katër viteve para se të fillonte papunësia. Kërkuari duhet të kërkojë punë me orar të plotë, si dhe të jetë i moshës 17-64 vjeç dhe i aftë për punë. Ai duhet të jetë i regjistruar në

entin e punësimit si punëkërkuar. Të hollat ditore të papunësisë paguhet maksimumi për 500 ditë. Madhësia e të hollave ditore është e njëjtë për të gjithë dhe është subjekt tatimi.

- **Asistenca e tregut të punës**

Emigrantit, asistenca e tregut të punës, i paguhet gjatë tre viteve të parë të qëndrimit të tij në Finlandë si asistencë integrimi. Kusht paraprak për asistencën e integritit është hartimi i planit të integritit në bashkëpunim me entin e punësimit dhe komunën. Kur të papunit nuk i pagohen më leverditë e papunësisë të varura nga rroga, ose kur i papuni nuk ka të drejtë të marrë të holla ditore të papunësisë, atëherë atij i pagohet asistenca e tregut të punës nga Kela. Kërkuar duhet të jetë 17-64 vjeç dhe i aftë për punë. Ai duhet të jetë i regjistruar në entin e punësimit si punëkërkuar. Nga personi i papunë i moshës nën 25 vjeç kërkohet, midis të tjerash, që ai të ketë shkollim profesional, ose që ai të mos ketë refuzuar ndonjë ofertë për punë, ose shkollim. Pagimi i asistencës së tregut të punës nuk ka afat kohor. Të ardhurat e bashkëshortit (bashkëshortes) mund të zvogëlojnë shumën e asistencës së tregut të punës, ose edhe të pengojnë në marrjen e saj. Asistenca e tregut të punës është subjekt tatimi.

- **Të hollat ditore të papunësisë të varura nga rroga**

Arkat e papunësisë në bashkëpunim me bashkimet profesionale i pagojnë të holla ditore personit që ka mbetur i papunë. Shuma përcaktohet në bazë të rrogës së punës para papunësisë dhe përgjithësisht është më e madhe se leverditë e papunësisë të paguara nga Kela. Këto të holla ditore pagohen për një periudhë dy-vjeçare. Si kusht absolut paraprak është që punëtori të ketë qenë anëtar i arkës së papunësisë për të paktën dhjetë muaj para fillimit të papunësisë dhe që punëtori të ketë paguar kuotën e anëtarësisë. Prandaj është e rëndësishme që menjëherë pas fillimit të punës, punëtori të interesohet se në cilën arkë të papunësisë të mund të anëtarësohet.

## **Pensionet**

Në Finlandë të ardhurat e të moshuarve janë të garantuara me anë të pensioneve popullore dhe pensioneve të punës. E drejta e të huajit për pension është e lidhur me banimin dhe kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës së personit në Finlandë. Mund të pyesësh në zyrën e Kelas a mund të marrë personi i moshuar, ose invalid në familjen tënde pension dhe sa mund të jetë shumën e pensionit. Në rast se pensioni nuk miratohet atëherë i moshuari mund të kërkojë ndihmë elementare nga komuna. Të gjithë pensionet janë subjekte të tatimit. Personi që merr vetëm pension popullor, në praktikë, nuk paguan tatim. Në Finlandë moshë e daljes në pension është 65 vjeç. Pensionet e parakohshme mundësojnë kalimin në pension përpara moshës së daljes në pension, por në këtë rast pensioni është më i vogël. Llojet kryesore të pensioneve janë pensioni popullor dhe pensioni i punës. Përveç tyre, nën kushte të caktuara mund të paguhet dhe pensionet familjare dhe të papunësisë. Kela paguan pensionin popullor, ndërsa institucionet pensionale të punës paguajnë pensionin e bazuar në punë. Pensioni i paaftësisë për punë i paguhet personave të moshës nën 65 vjeç kur ata nuk janë në gjendje të vazhdojnë punën e mëparshme, ose ndonjë punë të ngjashme. Zakonisht, pensioni paguhet pas ndërprerjes së të hollave ditore të pushimit mjekësor, pra rreth një vit pas fillimit të paaftësisë për punë. Pensionisti mund të marrë edhe asistencë qiraje e cila përcaktohet në varësi të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve banesore. Përveç kësaj mund të paguhet edhe asistencë përkujdesjeje. Qëllimi i kësaj asistence është të përkrahët dhe të ndihmohet në përkujdesjen shtëpiake pensionisti i sëmurë dhe invalid që jeton në shtëpi. Asistenca e qirasë dhe asistenca e përkujdesjes nuk janë subjekte tatimi.

- **Pensionin popullor**

Të huajtë me banim të përhershëm në Finlandë marrin pension popullor nëse ata kanë banuar në Finlandë për një kohë të caktuar (koha maksimale e kërkuar është 5 vjet pa ndërprerje). Shuma e

pensionit popullor përcaktohet në bazë të pensioneve të tjera dhe kohës së banimit në Finlandë. Në shumën e pensionit popullor ndikojnë edhe komuna ku banon personi si dhe marrëdhëniet e tij familjare.

- **Pensioni i punës**

Personi që del në pension pas punës ka të drejtë të marrë pensionin e punës. Shuma e pensionit varet nga vitet e punës dhe madhësia e rrogës. Pensioni i punës mblidhet në bazë të një shumë për çdo vit pune. Është detyra e punëdhënësit të kujdeset për pagimin ligjor të pensionit të punës, një pjesë të të cilit e paguan punëdhënësi dhe pjesën tjetër punëtori nga rroga e vet.

### **Asistenca e veçantë për emigrantë**

Në fillim të tetorit të vitit 2003 do të hyjë në fuqi një formë e re mbështetje financiare, me anë të së cilës i garantohet ndihmë elementare për kohën e pleqërisë dhe të paaftësisë për punë atyre emigrantëve me banim në Finlandë të cilët kanë nevojë për ndihmën elementare komunale me afat të gjatë kohor. Grupi më i madh i prekur nga kjo asistencë e miratuar është ai i të riatdhesuarve finlandezëve nga Ingermania. Asistenca e veçantë është ndihmesë sociale që bën pjesë në rrethin e kujdesit social. Ajo jepet në rast nevojë. Kusht paraprak për marrjen e kësaj asistence është mosha 65 vjeçare, ose paaftësia për punë. Gjithashtu, kusht për marrjen e asistencës është edhe banimi për të paktën pesë vjet rresht në Finlandë para fillimit të asistencës së veçantë. Asistenca e veçantë nuk është më shumë se pensioni popullor dhe marrësi nuk paguan tatime. Në shumën e asistencës ndikojnë përveç të ardhurave të kërkuarit edhe të ardhurat e bashkëshortit (bashkëshortes), si dhe pasuria e tyre. Enti popullor për sigurimin shëndetësor dhe pensional kujdeset për zbatimin e asistencës së veçantë.

Informata të mëtejshme: [www.kela.fi](http://www.kela.fi)

### **Ndihma elementare**

Ndihma elementare është mbështetja financiare e shkallës së fundit që bën pjesë në rrethin e kujdesit social. Qëllimi i kësaj ndihme është të garantojë të ardhura, si dhe të përkrahë jetesën e pavarur të personit. Klienti ka të drejtë për ndihmë elementare kur ai nuk merr të ardhura të mjaftueshme nga puna, ose nga sigurime të tjera. Shuma e ndihmës elementare përcaktohet në bazë të të ardhurave dhe pasurisë që personi ka në përdorim. Informata të mëtejshme mund të merrni nga zyra e socialit.

### **Pozita dhe të drejtat e klientit të kujdesit social**

Klienti ka të drejtë për kujdes dhe trajtim të mirë social pa diskriminim. Ligji për klientin e kujdesit social mbulon të gjitha fushat e kujdesit social. Zakonisht, klienti ka të drejtë të informohet për veten e vet. Por ai është i detyruar që autoriteteve zyrtare t'ju jap informacione për vetveten. Autoritetet zyrtare janë nën obligimin e ruajtjes së sekretit zyrtar. Kjo do të thotë që informatat konfidenciale nuk i jepen personave të jashtëm, as edhe të afërmëve.

Informata të mëtejshme mund të merrni nga zyra e socialit dhe nga broshura “Pozita dhe të drejtat e klientit të kujdesit social” (Sosiaalihuollon asiakkaan asema ja oikeudet). Broshurat gjenden në zyrat e socialit. Ato janë dhe në internet në adresën [www.stm.fi](http://www.stm.fi). Broshura është përkthyer në suedisht, gjermanisht, rusisht, anglisht dhe somalisht. Broshura është e shkruar në gjuhë të thjeshtë finlandeze dhe suedeze.

### **Avokati për çështjet sociale**

Në çdo komunë ka avokat për çështjet sociale. Në qoftë se klienti është i pakënaqur me shërbimin, ose trajtimin e ofruar ai mund të kontaktohet me avokatin për çështjet sociale.

Avokati për çështjet sociale këshillon dhe ndihmon klientët e kujdesit social. Ai informon klientët mbi të drejtat e tyre dhe ndjek nga afër trajtimin e klientit në komunë. Mund të informoheni në zyrat e socialit mbi mundësinë e kontaktimit me avokatin për çështjet sociale.

#### **4. Pushimet familjare të kujdesit për fëmijën**

Për shkak të lindjes dhe kujdesit për fëmijën, prindërit kanë të drejtë të marrin pushime familjare të kujdesit për fëmijën, të cilat përfshijnë pushimin amësor, pushimin atëror, pushimin prindëror (edhe i pjesshëm) dhe pushimin e kujdesit për fëmijën (edhe i përkohshëm dhe i pjesshëm). Kela paguan të holla ditore prindërore për kohën gjatë së cilës prindi është me pushim amësor, atëror dhe prindëror. Shuma e të hollave varet nga të ardhurat e prindërve. Për prindërit që nuk punojnë paguhet të hollat minimale ditore të ditëve të punës. Gjatë kohës së pushimit për kujdesin e fëmijës prindit i paguhet asistenca e kujdesit shtëpiak. Të hollat ditore prindërore dhe asistenca e kujdesit shtëpiak janë subjekte të tatimuaara.

##### **Pushimi amësor**

Pushimi amësor fillon rreth një muaj para kohës së lindjes së fëmijës. Kohëzgjatja e pushimit është 105 ditë pune. Gjatë pushimit amësor Kela i paguan nënës të holla amësore, në qoftë se nëna ka banuar në Finlandë jo më pak se 180 ditë para kohës së lindjes së fëmijës.

##### **Pushimi atëror**

Babai ka të drejtë për pushim atëror që zgjat 18 ditë pune, krahas kohës së pushimeve të paguara amësore dhe prindërore. Ky pushim 18-ditor mund të ndahet në jo më shumë se katër periudha të ndryshme. Përveç kësaj babai merr 1-12 ditë pune më shumë pushim atëror, në rast se ai e mban pushimin prindëror të paktën 12 ditë pune para përfundimit të periudhës së pagesës së të hollave prindërore. Atëhere nëna mund të kthehet në punë, ose të marrë për shembull pushimin vjetor. Kela paguan të holla atërore për kohën e pushimit atëror, në qoftë se babai nuk është në punë dhe kujdeset për foshnjën në shtëpi.

##### **Pushimi prindëror**

Pushimi prindëror fillon menjëherë pas periudhës së pagesës së të hollave amësore dhe kohëzgjatja e tij është 158 ditë pune. Gjatë pushimit prindëror nënës, ose babait i paguhet të holla prindërore. Prindërit bien dakort me njëri tjetrin se kush do të kujdeset për fëmijën në shtëpi. Periudha e pagesës së të hollave prindërore mund të ndahet midis prindërve. Pushimi prindëror mund të mbahet edhe i pjesshëm, në këtë rast babai dhe nëna mund të kujdesen me rradhë për fëmijën në shtëpi dhe të jenë në punë me orar të reduktuar. Për shembull, njëri prej prindërve mund të kujdeset për fëmijën në mëngjes, tjetri pasdite, ose kujdesi ditor për fëmijën dhe orari i punës mund të alternohen me njëri-tjetrin çdo ditë ose çdo javë. Babai dhe nëna merren vesh me punëdhënësit e tyre për kalimin në punë me orar të reduktuar. Kontrata për punën me orar të reduktuar nuk duhet të ketë kohëzgjatje më pak se dy muaj.

##### **Pushimi për kujdesin e fëmijës**

Prindërit e fëmijës së moshës nën 3-vjeç kanë të drejtë të qëndrojnë në shtëpi për tu kujdesur për fëmijën, pa ndërprerë marrëdhënien e punës. Kthimi në punë bëhet me kushtet e mëparshme. Pushimi për kujdesin e fëmijës mund të merret pas pushimit prindëror dhe atëror. Pushimi për kujdesin e fëmijës zgjat deri sa fëmija të mbushë moshën tre vjeç. Për periudhën e pushimit Kela paguan asistencën për kujdesin shtëpiak të fëmijës.

Pushim i pjesshëm për kujdesin e fëmijës mund të merret deri në fund të vitit, gjatë të cilit fëmija fillon shkollën fillore. Gjatë pushimit të pjesshëm për kujdesin e fëmijës prindi bën për një kohë të caktuar punë me orar të reduktuar. Gjatë periudhës së pushimit të pjesshëm për kujdesin e fëmijës prindit i paguhet asistencë e pjesshme për kujdesin shtëpiak të fëmijës.

Në rast se fëmija i moshës nën 10 vjeç sëmuret papritur, babai ose nëna ka të drejtë për pushim për kujdesin e fëmijës maksimumi katër ditë pune. Në këtë rast kusht paraprak për marrjen e pushimit është që të dy prindërit të jenë të punësuar jashtë shtëpisë.

### **Shtesat e fëmijëve**

Shtesat e fëmijëveve paguhen prindërve të fëmijës për çdo fëmijë të moshës nën 17 vjeç që banon në Finlandë. Shuma e shtesave të fëmijëve varet nga numëri i fëmijëve. Prindëri i vetëm merr për çdo fëmijë shtesë më të lartë të fëmijës. Shtesat e fëmijëve nuk janë subjekt tatimi. Shtesat për fëmijë kërkohen nga Kela.

### **Ndihma amësore**

Nëna, me banim në Finlandë, që pret fëmijë ka të drejtë për ndihmë amësore për periudhën e fundit të shtatzanisë. Kusht paraprak për këtë ndihmë është që nëna të ketë qenë në kontrollin mjekësor në këshillimore, ose te mjeku në qendrën shëndetësore katër muaj para përfundimit të shtatzanisë.

Ndihma amësore jepet ose si pako me ndihma për nënën, ose në formë të hollash të patatimuara. Megjithatë vlera e pakos është dukshëm më e madhe se shumata e hollave. Pakoja përmban rroba të cilësisë së lartë për foshnjën dhe pajisje për kujdesin e foshnjës. Me atë të tyre siguron fillimin e mbarë të përkujdesjes për foshnjën.

## **5. Kujdesi ditor dhe edukimi i hershëm i fëmijëve**

Me kujdes ditor nënkuptohet kujdesi ditor i fëmijës jashtë shtëpisë. Edukimi i hershëm është edukimi, mësimi dhe kujdesi për fëmijën i dhënë gjatë kujdesit ditor. Qëllimi i kujdesit ditor dhe i edukimit të hershëm është ndihmesa për prindërit në rritjen e fëmijëve dhe përkrahja e zhvillimit dhe aftësive mësimore të fëmijës në bashkëpunim me familjen. Njëkohësisht fëmija lidh miqësi të reja dhe njihet me mënyrën e jetesës finlandeze dhe gjuhën. Në kujdesin ditor përkrahet si kultura ashtu edhe gjuha amtare e fëmijës, sepse është e rëndësishme që fëmija të dijë gjuhën amtare. Prindërit mund të bisedojnë me personelin e kujdesit ditor dhe të paraqesin sugjerime për fëmijën.

### **Çerdhe apo kujdesi ditor familjar?**

Komuna e banimit ofron kujdes ditor për fëmijët nën moshën shkollore. Kujdesi ditor është zakonisht i organizuar në çerdhe ose në kujdes ditor familjar. Në çerdhe fëmijët janë të ndarë në grupe dhe për ta kujdeset personeli i shkolluar. Kujdesi ditor familjar nënkupton atë që një kujdestare familjare e punësuar nga komuna kujdeset në shtëpinë e saj për një grup fëmijësh. Përveç kujdesit ditor familjar të organizuar nga komuna, për fëmijët ka çerdhe private dhe kujdestare të kujdesit ditor. Fëmija mund të jetë në kujdes ditor të plotë, të pjesshëm, ose vetëm disa ditë në javë. Në komunat më të mëdha ka çerdhe të hapura 24 orë. Ato janë për fëmijët e prindërve që shkojnë në punë me ndërrime.

### **Parqet zbavitëse**

Përveç kujdesit ditor ka edhe parqe zbavitëse të organizuar nga komuna, ku mund të shkohet pa u regjistruar paraprakisht dhe pa pagesë. Personeli i parkut zbavitës organizon programe për fëmijë. Fëmijët e moshës nën 4 vjeç kanë nevojë për kujdestar me vete. Në disa prej parqeve zbavitëse ka të ashtuquajtura “teta”, të cilat kujdesen për fëmijët kundrejt një pagese të veçantë.

### **Çerdhet e hapura**

Në shumë komuna ka çerdhe të hapura nën kujdesin e komunës. Në to mund të shkohet pa u regjistruar paraprakisht dhe pa pagesë. Në çerdhet e hapura prindërit marrin pjesë në kujdesjen e fëmijëve të tyre. Aty mund të përftohen ide të reja dhe përkrahje në kujdesin e fëmijës, si dhe mund të takohen të rritur të tjerë.

### **Kujdesi ditor për fëmijën gjatë shkollimit të emigrantit**

Komuna që pranon emigrantë organizon për prindërit shkollim njëvjeçar për emigrantë. Gjatë periudhës së shkollimit komuna organizon kujdes ditor për fëmijët e moshës parashkollore në mënyrë që nënat me fëmijë të vegjël të kenë mundësi për të studiuar e mësuar gjuhën finlandeze dhe për tu njohur me shoqërinë e re. Kujdesi ditor gjatë periudhës së shkollimit është pa pagesë për emigrantët.

### **Kërkesa për kujdes ditor**

Vendi për kujdes ditor duhet kërkuar katër muaj përpara. Për ata që kanë marrë vend pune, ose studimi kujdesi ditor organizohet edhe më shpejt. Kontaktohuni me kohë me zyrën sociale të komunës, ose me çerdhen ditore më të afërt. Prej tyre mund të informoheni se si kërkohet vendi për kujdes ditor dhe mbi mundësi të ndryshme të organizimit të kujdesit ditor.

### **Pagesat e kujdesit ditor**

Pagesat e kujdesit ditor përcaktohen në bazë të madhësisë së familjes dhe të ardhurave të saj. PAGESA bëhet një herë në muaj.

### **Mësimi parashkollor para fillimit të shkollës**

Mësimi parashkollor organizohet për të gjithë fëmijët e moshës 6 vjeç para fillimi të shkollës. Në mësimin parashkollor praktikohen njohuritë bazë që fëmija ka nevojë në shkollë. Kjo lehtëson fillimin e shkollës. Mësimi është pa pagesë, zgjat të paktën gjysmë dite për një periudhë njëvjeçare. Pjesëmarrja në parashkollim është me dëshirë të lirë, por e rekomandueshme. Informata më të hollësishme mbi mësimin parashkollor mund të merrni nga çerdhja, ose shkolla pranë vendbanimit tuaj.

### **Aktivitetet e lira për të rinj**

Për të rinjtë ofrohen aktivitete të lira të larmishme. Ato organizohen nga organizata të ndryshme rinie, shoqata sportive, organizata popullore, shkolla dhe nga kompani tregtare. Në shumicën e komunave ka dhe vende, ose shtëpi rinie veçanërisht për të rinjtë ku organizohen aktivitete të larmishme, nga aktivitete arti e sporti deri te kompjuterat e klubet e mjeteve të motorizuara. Gjatë këtyre aktiviteteve të rinjtë mund të njihen me moshatarë dhe të praktikojnë gjuhën finlandeze. Për shembull, shoqatat sportive janë shumë të preferuara dhe në aktivitetet e tyre marrin pjesë të rinj të moshave të ndryshme. Informata mbi aktivitete e lira mund të merren nga shtëpia e rinisë, nga gazeta lokale dhe nga organizatorët e aktiviteteve.

## **6. Nga martesë në divorc**

Martesa është një kontratë me dëshirë të lirë, e cila mund të priset. Divorcet janë të zakonshme në Finlandë. Divorci fillohet duke dorëzuar formularin përkatës në gjykatën komunale të vendbanimit tuaj. Gjykata komunale nuk heton shkaqet e ndarjes, as marrëdhëniet personale midis bashkëshortëve. Divorci miratohet edhe nëse pala tjetër të mos jetë dakort me të. Informata të mëtejshme mund të merren nga broshura “Tasa-arvoisena Suomessa: tietoa maahanmuuttajanaiselle ja miehelle”, e cila është hartuar në bashkëpunim midis Ministrisë së Punës, Zyrës së Përfaqësuesit

të Minoriteteve dhe Këshillit të Çështjeve të Barazisë. Broshura gjendet dhe në adresën internetore [www.mol.fi/migration](http://www.mol.fi/migration)

### **Alimentacioni**

Prindërit e fëmijës janë të detyruar të kujdesen për jetesën e fëmijës. Në qoftë se prindërit ndahen, ose nuk jetojnë së bashku, atëhere fëmija ka të drejtë për alimentacion nga prindi me të cilin nuk jeton. Fëmija ka, gjithashtu, të drejtë të takojë të dy prindërit e tij. Alimentacioni mund të vendoset me kontratë e cila bëhet në zyrën komunale të socialit në praninë e mbikqyrësit të fëmijëve. Mundësia tjetër është që gjykata komunale të marrë vendim për alimentacionin. Shuma e alimentacionit varet nga gjendja financiare e prindërve dhe nevoja për alimentacion e fëmijës.

### **Subvencioni**

Fëmija ka të drejtë për subvencion nga komuna në qoftë se prindërit kanë neglizhuar pagesën e alimentacionit, i cili është konfirmuar me vendim gjyqi, ose me kontratë të bërë midis prindërve. Subvencioni kërkohet nga autoriteti social i komunës së vendbanimit të fëmijës. Komuna që paguan subvencionin inkason alimentacionet e papaguara nga personat përgjegjës për pagimin e alimentacionit. Në qoftë se për shkak të pamundësive financiare të përgjegjësit për alimentacion, alimentacioni është më i vogël se subvencioni, fëmija ka të drejtë të marrë subvencion të plotë. Në këtë rast diferenca e paguar me subvencion nuk inkasohet nga përgjegjësi për alimentacion. Subvencioni paguhet edhe për fëmijën e lindur jashtë martese, babai i të cilit nuk është konfirmuar, si dhe për fëmijën e adoptuar nga njëri prej prindërve.

## **7. Shkollimi dhe mësimi**

Çdo fëmijë që jeton në Finlandë është i detyruar të shkollohet. Ai ka të drejtë të ndjekë shkollën fillore pa pagesë. Fëmijët e fillojnë shkollën fillore në fillim të semestrit të vjeshtës, zakonisht vitin kur mbushin 7 vjeç. Shumica e fëmijëve shkojnë në shkolla pranë vendbanimeve të tyre. Prindërit duhet të kontaktohen me autoritetet zyrtare të arsimit të komunës, ose me shkollën.

### **Shkolla fillore**

Shkolla fillore zgjat nëntë vjet. Në disa shkolla ka dhe klasë të dhjetë e cila ndiqet me dëshirë të lirë. Pas përfundimit të shkollës fillore shumica e të rinjve vazhdon shkollimin në gjimnaze, ose në institute shkollore profesionale. Vajzat dhe djemtë kanë mundësi të njëjta për shkollim. Për emigrantët mund të organizohet fillimisht mësimi në grupe të veçanta shkolle. Pas transferimit në klasën finlandeze nxënësi mund të ndihmohet edhe në gjuhën amtare.

- **Ushqimi**

Në shkollat fillore ushqimi është pa pagesë. Nëse nxënësi ka dietë të veçantë ushqimore atëhere për të mund të bisedohet me shkollën në veçanti, para se fëmija të fillojë shkollën.

- **Mësimi fetar**

Në shkollë jepet mësim fetar. Gjithashtu, në shkollë organizohet edhe mësimi i këndvështrimit të jetës në vend të mësimit fetar. Prindërit mund të bisedojnë mbi mundësitë e ndryshme me mësuesin e fëmijës.

### **Gjimnazi dhe institutet shkollore profesionale**

Pas shkollës fillore të rinjtë vazhdojnë studimet në shkollimin gjimnazor, ose në shkollimin bazë profesional. Kërkesa për gjimnaz dhe për të gjitha institutet shkollore profesionale që fillojnë pas

përfundimit të shkollës fillore bëhet njëkohësisht dhe në mënyrë të përbashkët. Nxënësit zgjidhen në bazë të rezultateve në mësim, por në disa shkolla profesionale ka dhe provim pranimit, ose provim gjuhe. Emigranti mund të zgjidhet edhe në bazë të kriterit më elastik, në rast se ai nuk ka dëftesë pjekurie finlandeze të shkollës fillore.

Programi mësimor profesional që zgjat tre vjet të përgatit për një profesion të caktuar. Para këtij shkollimi, emigrantët mund të marrin pjesë në shkollimin përgatitor për shkollim profesional, i cili zgjat një vit.

Shkollimi gjimnazor zgjat 2 – 4 vjet dhe është shkollë për formim të përgjithshëm të nxënësit, në përfundim të së cilës jepet provimi i maturës. Gjuha e huaj merret parasysh në mënyra të ndryshme në diplomën e pjekurisë. Pas gjimnazit është e mundur të aplikohet në të gjithë universitetet dhe shkollat e larta. Edhe shkollimi profesional trevjeçar të jep mundësinë për të aplikuar në shkollën e lartë.

Të rriturit mund të japin provim të shkollës fillore dhe gjimnazit, ose thjesht lëndë të veçanta në gjimnazin për të rritur, ku mësimi jepet në darkë. Në institucionet shkollore profesionale ka linja të veçanta për të rritur.

### **Shkollimi i integrit**

Emigrantëve mundohet tu garantohen pozita të barabarta me finlandezët në përdorimin e shërbimeve arsimore dhe leverdive sociale për shkollim. Shkollimi përgatit në marrjen e vendimeve të ndërjegjshme për jetën. Emigranti me banim në Finlandë, që është i detyruar të shkollohet ka të drejta të njëjta me finlandezët lidhur me shkollimin fillor. Gjithashtu emigrantit i garantohet shkollimi i nevojshëm për punë, kualifikim dhe zhvillim të aftësive profesionale. Qëllimi është që gradat shkencore dhe studimet e kryera jashtë shtetit të shërbejnë si bazë në hartimin dhe plotësimin e shkollimit në Finlandë. Gjithashtu, synohet që dygjuhësia të funksionojë lehtësisht: dituria e finlandishtes, ose suedishtes dhe ruajtja e gjuhës e kulturës amtare.

Shkollimi i integrit ndihmon dhe përkrah integrimin e emigrantëve në shoqërinë finlandeze. Informata të mëtejshme për integrimin mund të gjeni në broshurën e botuar nga Ministria e Punës me titullin “Maahanmuuttajien kotoutuminen Suomeen” dhe në adresën internetore [www.mol.fi/migration](http://www.mol.fi/migration)

### **Shkollat e larta, shkollat e larta profesionale dhe universitetet**

Studentët e shkollave të larta, e shkollave të larta profesionale dhe të universiteteve zgjidhen me anë të dëftesave dhe të provimeve të pranimit. Kriteret e pranimit të shkollave ndryshojnë nga njëri-tjetri, prandaj nxënësi duhet me kohë të kontaktohet drejtpërdrejt me shkollën për të cilën është i interesuar. Në shumicën e universiteteve, shkollave të larta profesionale dhe shkollave të larta ka instruktorë për të huaj. Si dhe, universiteti veror organizon mësim gjatë verës. Në të mund të merret pjesë edhe pa qenë student në universitet.

### **Shkollat popullore**

Në shkollat popullore mund të mësohet shkollimi fillor, gjimnazor, ose lëndë të veçanta. Përveç këtyre, shkollat popullore organizojnë edhe shkollim profesional. Në disa shkolla popullore ka linjë të veçantë për emigrantët. Mësimi është i plotë dhe nxënësit zakonisht banojnë në konvikte.

### **Institutet popullore dhe institutet e punëtorëve**

Në shumicën e komunave në Finlandë ka institute popullore, ose institute të punëtorëve. Ato janë vende të preferuara studimi nga të rriturit. Në institutet popullore dhe institutet e punëtorëve

studiohet në kohën e lirë, zakonisht një herë në javë. Lëndët më të preferuara janë gjuhët e huaja. Gjithashtu, në këto institute mund të studiohen shumë lëndë të ndryshme praktike, ose të artit dhe mund të praktikoni fiskulturë. Informata të mëtejshme në adresën internetore [www.ktol.fi](http://www.ktol.fi)

### **Bursa për studim**

Bursa për studim mund të kërkohet prej Kelas në rast se studion në gjimnaz, shkollë popullore, në institut profesional, si dhe në universitet dhe në shkolla të larta. Studimi duhet të jetë aktivitet kryesor dhe kohëzgjatja e tij jo më pak se dy muaj. Kusht për bursën është pranimi në shkollë dhe nevoja për financim. Studenti pa familje mund të marrë shtesë banesore, e cila përcaktohet në bazë të madhësisë së qirasë. Studentët që banojnë me familjet e tyre mund të kërkojnë asistencë të përgjithshme qiraje.

Studenti mund të marrë hua prej bankës. Huaja garantohet nga shteti. Kamatat e huasë i duhen paguar bankës gjatë viteve të studimit, por vetë huaja zakonisht paguhet pas përfundimit të studimeve.

### **Bursa për shkollim**

Bursa për shkollim i paguhet personit të papunë i cili është pjesëmarrës në shkollimin e fuqisë punëtore. Edhe shkollimi për emigrantë është shkollim i fuqisë punëtore. Bursa për shkollim është pak më e madhe se asistenca e papunësisë.

## **8. Kujdesi shëndetësor**

### **Qendrat shëndetësore**

Në çdo komunë dhe qytet ka qendër shëndetësore, e cila merret me kujdesin themelor shëndetësor të banorëve. Informohuni se cilës qendër shëndetësore i përket; zakonisht është qendra shëndetësore që gjendet pranë vendbanimit tuaj. Qendra shëndetësore inkason për vizitat te mjeku për të rritur një kuotë vjetore, ose një pagesë të vetme, e cila nuk mund të inkasohet më shumë se tre herë në vit. Shërbimet shëndetësore për fëmijët e moshës nën 15 vjeç janë pa pagesë. Vizitat te motra medicinale në qendrën shëndetësore janë edhe për të rriturit pa pagesë.

Koha për vizitë te mjeku i qendrës shëndetësore duhet rezervuar paraprakisht. Vetëm në raste shumë urgjente mund të bëhet vizita pa rezervim. Qëllimi është që në rastet jo urgjente koha e pritjes për ekzaminime dhe mjekim të mos jetë më tepër se tre ditë. Qendrat shëndetësore janë të hapura si natën ashtu edhe gjatë fundjavës; natyrisht jo të gjitha.

Edhe shërbimet dentare gjenden në qendrat shëndetësore, megjithatë qendrat shëndetësore të qyteteve të mëdhaja nuk mund të kurojnë dhëmbët e gjithë të rriturve. Prandaj mund të kërkohen nga Kela kompensime për kujdesin dentar te dentisti privat.

### **Këshillimoret për nëna**

Këshillimoret për nëna dhe fëmijë ndodhen në qendrat shëndetësore. Gjendja shëndetësore e gruas shtatzënë dhe e foshnjës ndiqen në këshillimoret për nëna gjatë gjithë periudhës së shtatzënisë. Në këshillimoret duhet shkuar katër muaj para mbarimit të shtatzënisë, sepse është kusht për marrjen e ndihmës amësore. Në rast se dëshirohet mund të shkohet te mjeku privat, por në Finlandë gati të gjitha gratë shtatzënë përdorin shërbimet e këshillimores. Këshillimorja organizon dhe kurse të përgatitor për lindje dhe kurs përgatitor familjar për prindërit që presin fëmijën. Në Finlandë shumica e baballarëve merr pjesë në këto kurse.

Në Finlandë gratë linden zakonisht në spital. Shumica e baballarëve marrin pjesë në lindje. Këshillimoret organizojnë edhe vizita njohëse në maternitetet.

Shërbimet e këshillimores janë pa pagesë për klientin.

### **Këshillimoret për fëmijë**

Kontrolli i nënës pas lindjes bëhet në këshillimoren për nëna, por më vonë fëmija dhe familja bëhen klientë të këshillimores për fëmijë. Në këshillimore ndiqet shëndeti dhe zhvillimi i fëmijës, si dhe përkrahet familja në mënyra të ndryshme. Në këshillimore fëmija merr dhe vaksinat që bëjnë pjesë në programin vaksinor të Finlandës. Nëna dhe babai së bashku mund ta sjellin fëmijën në këshillimore.

Këshillimoret për fëmijë organizojnë për nënat, baballarët dhe gjithë familjen kurse dhe bashkëbisedime. Familjet pjesëmarrëse mund të njihen me familje të tjera në kushte të ngjashme dhe mund të marrin ndihmë eksperte lidhur me shëndetin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijës.

Shërbimet e këshillimoreve për fëmijë janë pa pagesë për klientin.

### **Kujdesi shëndetësor në shkollë**

Kur fëmija shkon në shkollë ai transferohet nga këshillimorja për fëmijë në rrethin e kujdesit shëndetësor të shkollës. Motra medicinale e shkollës është në shkollë zakonisht dy ditë në javë, gjatë të cilave fëmijët mund të shkojnë për kontroll. Edhe prindërit mund të kontaktohen me motrën medicinale të shkollës.

Programi vaksinor i filluar në këshillimore vazhdohet në shkollë. Motra medicinale e shkollës kryen kontrollë mjekësore të rregullta të fëmijës, ndërsa mjeku i shkollës i kontrollon më rrallë fëmijët. Problemet që mund të ketë fëmijë duhet t'i tregohen motrës medicinale ose mjekut të shkollës, sepse përmes tyre fëmija mund të vizitohet, për shembull, te psikologu, ose te terapisti për të folurën. Dhëmbët e nxënësve kontrollohen rregullisht dhe mjekohen në qendrën shëndetësore.

Komunat ofrojnë kujdes shëndetësor për nxënësit e shkollave fillore, shkollave profesionale dhe gjimnazeve. Fondacioni i kujdesit shëndetësor për studentë përgjigjet për kujdesin shëndetësor të studentëve të shkollave të larta.

Kujdesi shëndetësor në shkollë dhe kujdesi dentar i nxënësve është pa pagesë për klientët.

### **Kujdesi shëndetësor për të sëmurin**

Për të bërë ekzaminimet dhe mjekimin në spital nevojitet rekomandim nga mjeku i qendrës shëndetësore, ose mjeku privat. Në raste urgjente nuk ka nevojë për rekomandim. Qëllimi është që ekzaminimet në poliklinikën e spitalit të bëhen tre javë pas mbërritjes së rekomandimit të mjekut në spital dhe mjekimi të bëhet jo më vonë se një muaj pas vënies re të nevojës për mjekim në poliklinikë. Shpesh, radhët e pritjes janë më të gjata.

Pacienti i mjekuar në spital paguan një shumë të arsyeshme njëditore, ku përfshihen ekzaminimet, masazh mjekësor, ilaçet, mjekimi dhe ushqimi.

### **Kujdesi shëndetësor privat**

Veçanërisht në komuna të mëdha ka mjekë dhe dentistë privatë. Në Finlandë ka edhe disa spitale privatë. Kujdesi shëndetësor privat është shpesh shumë më i shtrenjtë se kujdesi shëndetësor në

qendrat shëndetësore, ose në spitale publike. Kela kompenson një pjesë të çmimit të mjekimit të dhënë nga mjeku dhe dentisti privat.

### **Ilaçet**

Ilaçet mund të blihen vetëm nga barnatorja. Kela kompenson një pjesë të çmimeve të ilaçeve me recetë nga mjeku.

### **Të drejtat e pacientit**

Në Finlandë është në fuqi ligji mbi të drejtat e pacientit. Pikat kryesore të ligjit janë:

- ❖ Pacienti ka të drejtë për mjekim dhe trajtim të mirë. Gjuha amtare, kultura dhe nevojat personale të pacientit merren parasysh sipas mundësive.
- ❖ Mjekimi i pacientit bëhet me pëlqimin e tij.
- ❖ Pacientit i tregohet mbi gjendjen e tij shëndetësore dhe mjekimin: çfarë përfshihet në mjekim, rreziqet e lidhura me të dhe mundësitë e ndryshme të mjekimit që ka pacienti. Pacienti mund ta refuzojë mjekimin.
- ❖ Pacientit që është në rradhë i njoftohet shkaku i pritjes dhe kohëzgjatja e përparës.
- ❖ Mendimi i fëmijës që është pacient merret parasysh vetëm nëse fëmija është aq i zhvilluar sa ta shprehë atë. Mjeku, ose eksperti do të vlerësojë zhvillimin e fëmijës.
- ❖ Kujdestari i fëmijës nuk ka të drejtë të refuzojë mjekimin e fëmijës në rast se gjendja shpirtërore, ose shëndeti i fëmijës është në rrezik.
- ❖ Personi i pakënaqur me mjekimin mund të ankohet te institucioni mjekësor, ose të ngrejë padi kundër organit mbikqyrës për kujdesin shëndetësor, zakonisht administratës rajonale.
- ❖ Institucioni mjekësor duhet të ketë një avokat për pacientin.

## **9. Shërbimet për invalidë**

Në Finlandë përpiqemi që invalidët të shkojnë në shkollë, të mësojnë, të jetojnë dhe të punojnë si të barabartë me të tjerët. Sipas ligjit të shërbimeve për invalidë komuna organizon shërbime dhe mbështetje ekonomike. Në rehabilitim përfshihen, midis të tjerash mjetet ndihmëse dhe kursi i përshtatjes. Shërbimet e transportit, të përkthyesit, të transferimeve në banesa të reja dhe shërbimet banesore janë shërbime që i përkasin të drejtës subjektive. Rehabilitimi mjekësor organizohet përmes kujdesit shëndetësor.

Për miratimin e shërbimeve të ndihmësit vendoset sipas çështjes në fjalë. Ndihmësi ndihmon në punët e përditshme, në shkollë, ose në mbarëvajtjen në punë.

Organizatrat e invalidëve, zyrat sociale dhe spitalet japin informata të mëtejshme lidhur me shërbimet për invalidë dhe rehabilitimin.

### **Asistenca e Klas për invalidë dhe të sëmurë kronikë**

- **Të hollat e kujdesit të veçantë për prindërit e fëmijës**

Nëna, ose babai mund të marrë të holla të kujdesit të veçantë për fëmijën, që tatimohen, në qoftë se ai/ajo kujdeset vetë për fëmijën e moshës nën 16 vjeç në spital, ose në raste të veçanta në shtëpi. Këto të holla mund të paguhet edhe kur nëna, ose babai nuk mund të shkojë në punë për shkak të kujdesit për fëmijën, e kështu nuk merr rrogë. Të hollat e

kujdesit të veçantë përcaktohen në bazë të të ardhurave të kujdestarit dhe të hollat paguhen zakonisht për jo më shumë se 60 ditë pune në vit.

- **Asistenca për fëmijën e sëmurë ose invalid**

Kela paguan për fëmijën invalid, ose fëmijën me sëmundje kronike asistencë të veçantë financiare me qëllim ndihmesën në kujdesjen për fëmijën në shtëpi. Asistenca i paguhet fëmijës nën moshën 16 vjeç, i cili ka nevojë për minimumi gjashtë muaj kujdesje dhe kjo shkakton shpenzime të mëtejshme.

Në marrjen e asistencës nuk influencojnë të ardhurat e familjes dhe asistenca nuk tatimohet.

- **Asistenca për invalidë**

Personi i sëmurë, ose invalid i moshës 16 - 64 vjeç mund të marrë prej Kela asistencë për invalidë. Asistenca paguhet në rast se aftësia për punë është dobësuar brenda një periudhë njëvjeçare. Asistenca nuk është subjekt tatimi. Ata invalidë të cilët nuk mund të punojnë mund të kërkojnë pension invalidor nga Kela.

- **Rehabilitimi**

Personi me invaliditet të rëndë i moshës nën 65 vjeç mund të kërkojë rehabilitim për një kohë të gjatë të organizuar nga Kela, ose rehabilitim intensiv mjekësor. Kela mund të paguajë për rehabilitim profesional. Edhe kompanitë e sigurimeve mund të paguajnë për rehabilitimin. Për kohën gjatë së cilës jeni në rehabilitim mund të kërkonit të holla për rehabilitim, në rast se qëllimi i rehabilitimit është vazhdimi i punës, ose kthimi në punë. Të hollat paguhen që prej kohës kur personi është penguar të punojë.

## 10. Shërbimet për të moshuarit

Në Finlandë të moshuarit rrallëherë jetojnë me fëmijët e tyre të rritur. Zakonisht, të moshuarit jetojnë në banesat e tyre, në banesa për të moshuar, ose në shtëpi të pleqve. Ndhima nga fëmijët dhe nipat e mbesat e tyre janë të rëndësishme për të moshuarin. Kur ndihma nga të afërmit nuk mjafton, për shembull për shkak të punës, të moshuarit mund të marrin ndihmë nga jashtë.

### Shërbimet në shtëpi

I moshuari që jeton në shtëpi mund marrë ndihmë nga jashtë, ndihmë profesioniste në rast nevojë. Qëllimi është që i moshuari të mund të jetojë në banesën e vet sa më shumë të jetë e mundur. I moshuari mund të kërkojë prej zyrës së shërbimeve sociale të komunës ndihmë në punët e përditshme në shtëpi, të cilat nuk mund të kryen vetëm. Personeli i shërbimeve në shtëpi mund të ndihmojë në mjekim dhe të kujdeset për të moshuarin, midis të tjerash ndihmon në blerjen e sendeve në dyqan, në gatim, në larje dhe pastrim. Klienti paguan për shërbimet sipas të ardhurave. Të moshuarit mund të blejnë edhe shërbime ushqimore, pra ushqimeve të ngrohta dhe me çmim të arsyeshëm që çohen drejt e në shtëpi në orën e caktuar. Gjithashtu, në disa komuna ka qendra të veçanta për të moshuar, ku të moshuarit mund të shkojnë të hanë, si dhe të marrin pjesë në aktivitete mësimore dhe aktivitete të kohës së lirë.

### Banesat për të moshuar dhe shtëpitë e pleqve

Për të moshuarit që nuk mund të jetojnë dot vetëm në shtëpi ka banesa për të moshuar. Banesat janë banesa të zakonshme me qira, ose banesa të ndërtuar me qëllim që në to personeli kujdestar të jetë i

gatshëm në rast nevoje. Të moshuarit jetojnë në shtëpi të pleqve në rast se ata nuk jetojnë dot pa kujdes të vazhdueshëm.

## **11. Si financohet mbrojtja sociale?**

Mbrojtja sociale financohet nga paguesit e tatimeve, të cilët në Finlandë i paguajnë shtetit dhe komunës tatime të të ardhurave dhe pasurisë që kanë. Me anë të tatimeve financohet mbrojtja sociale dhe shërbimet publike. Shoqëria me anë të vjeljes së tatimeve mirëmban, midis të tjerash edhe rrjetin rrugor dhe hekurudhor si dhe transportin publik.

Punëdhënësit duhet gjithmonë në fillim të punës t'i jepet karta tatimore, e cila merret nga zyra komunale e tatimeve.

Punëdhënësi duhet gjithmonë të sigurojë punëtorin, le të jetë ky finlandez, ose emigrant, i ri, ose i rritur. Atëherë punëtori është i regjistruar në rrethin e pensionit të varur nga rroga dhe të mbrojtjes sociale në rast papunësie, paaftësie për punë dhe në rast se punëtori është i moshuar. Mbrojtja e llogaritur në bazë të rrogës është zakonisht më shumë se mbrojtja themelore e paguar nga Kela. Për shembull pensioni i punës grumbullohet nga pagesat për pension të punëtorit dhe punëdhënësit. Në praktikë për sigurimin kujdeset punëdhënësi, i cili pakëson nga rroga e punëtorit përveç tatimeve edhe pjesën e punëtorit për sigurime. Nga Qendra e Pensioneve mund të merrni një kopje të regjistrit të marrëdhënies së punës suaj. Aty shihen rrogat e paguara, në bazë të të cilave paguhet pensioni i punës.

## **12. Nga mund të merret ndihmë nëse keni problem?**

### **Numrat e rëndësishëm të telefonit**

Mbajeni numërorin telefonik afër. Numrat e rëndësishëm shënojnë në një listë të veçantë pranë telefonit.

### **Urgjenca**

Numri i përgjithshëm i urgjencës është 112. Ky numër përdoret në gjithë Finlandën. Telefonimi në këtë numër është pa pagesë. Kur telefononi në këtë numër në vendngjarje mbërrin autoambulanca, policia dhe zjarrfikësit.

### **Shërbimet për sëmundje mendore dhe shërbimet për kriza**

Nëse jeta e re ju mundon, ose keni probleme me familjen, ose bashkëshortin/bashëshorten, nuk duhet të hezitoni në kërkimin e ndihmës. Problemet kurohen më mirë në fazat fillestare të tyre. Për kërkimin e ndihmës nuk ka nevojë për rekomandime të veçanta, por rezervoni kohën gjithmonë paraprakisht. Kur të rezervoni kohën duhet të tregoni nëse keni nevojë për përkthyes.

### **Zyrat e sëmundjeve mendore dhe këshillimet për familje**

Zyrat e sëmundjeve mendore japin këshilla dhe organizojnë ekzaminime dhe mjekime lidhur me probleme të shëndetit mendor. Edhe nga këshillimet komunale për familje mund të merrni këshilla, mund të bëni ekzaminime dhe mjekime pa pagesë. Ndihmë ofrohet në problemet lidhur me marrëdhëniet njerëzore, jetën familjare dhe edukimin e fëmijëve.

**Informata të mëtejshme:****SOS-keskus (Qendra SOS)**

Qendër për kriza në Helsinki. I shërben të gjithë emigrantëve dhe familjeve të tyre që banojnë në Finlandë në problemet e shëndetit mendor dhe në problemet sociale. Shërbimet janë pa pagesë. Koha duhet rezervuar paraprakisht.

SOS-keskus

Maistraatinportti 4 A, kati 4

00240 HELSINKI

tel. (09) 413 505 01 (kujdestaria është hapur ditëve të punës nga ora 9 –15)

telefaks: (09) 4135 0570

[www.mielenterveysseura.fi](http://www.mielenterveysseura.fi)

**Lounais-Suomen Mielenterveysseura ry. (Qendra e Shoqatës së Shëndetit Mendor për Finlandën Jugperëndimore)**

Kjo qendër ofron për emigrantët dhe familjet e tyre që jetojnë në zonat jugperëndimore të Finlandës mbështetje pa pagesë dhe ndihmë në situata të vështira të jetës.

Lounais-Suomen Mielenterveysseura ry.

Qendra e krizës, Stacioni i Turkut

Yliopistonkatu 24 a B 4, kati 6

20100 Turku

tel. (02) 233 3442 (kujdestaria është hapur gjatë ditëve të punës nga ora 10-15)

faks. (02) 273 8779

**Kidutettujen kuntoutuskeskus (Qendra e rehabilitimit për të torturuarit)**

Nga qendra e rehabilitimit për të torturuar marrin ndihmë të gjithë ata refugjatë të torturuar dhe familjarët e tyre. Edhe azilkërkuesi mund të kërkojë mjekim nga kjo qendër. Kohën mund ta rezervoni me telefon, letër, ose duke shkuar në qendër. Mund të pyetni edhe punëtorin social për të rezervuar kohën për ju.

Mäkelänkatu 58 – 60, kati 4

00150 HELSINKI

tel. (09) 7750 4584, gjatë ditëve të punës ora 8.30-15.00

faks. (09) 260 0220

[kitu@helsingindiakonissalaitos.fi](mailto:kitu@helsingindiakonissalaitos.fi)

Qendra e rehabilitimit për të torturuar

Munkkisaarencatu 16 A

01500 Helsinki

te. (09) 7750 7584

**Shtëpitë e strehimit**

Shtëpitë e strehimit ofrojnë vendstrehim për anëtarët e familjes, të cilët në shtëpi janë viktimë e dhunës shpirtërore, ose fizike. Thuajse të gjithë klientët janë nëna, por edhe baballarët mund të strehohen në shtëpitë e strehimit. Edhe fëmijët mund të merren me vete në shtëpinë e strehimit. Shtëpi strehimi ka në të gjitha komunat e mëdha, në komunat më të vogla ka banesa të veçanta për raste urgjente.

Informatat kontaktuese të shtëpisë më të afërt të strehimit mund t'i merrni prej punëtorit social të komunës. Në raste urgjente edhe policia e komunës ndihmon në gjetjen e shtëpisë së strehimit, në rast se zyra e socialit është e mbyllur.

### **Klinikat A**

Në klinikën A mund të shkoni në rast se ju, ose i afërmi juaj vuan nga intoksikacioni. Në klinikë kurohen probleme që kanë të bëjnë me varjen nga alkooli, ilaçet, droga si dhe probleme të tjera të kësaj natyre. Mund të shkoni në klinikë për të ndërprerë ciklet e intoksimit, ose për të kaluar krizat e shkaktuara nga përdorimi i lëndëve intoksikuese. Mund të pyetni në zyrën e socialit të komunës tuaj për informatat kontaktuese të klinikës A më të afërt.

### **Ndihma legale**

Zyrat komunale të ndihmës legale ndihmojnë në çështjet ligjore. Në këto zyra gjeni edhe shërbimet për ndihmës legal në proceset gjyqësore. Shërbimet paguhen sipas situatës financiare të personit. Personi me të ardhura të pakta mund të marrë pa pagesë ndihmës legal për procesin gjyqësor.

### **Zyra e përfaqësuesit të minoriteteve**

Përfaqësuesi i minoriteteve ndjek nga afër pozitën e të huajve dhe zhvillimin e të drejtave të tyre, njofton për legjislacionin për emigrantë si dhe jep këshilla në çështjet lidhur me sigurimin e të drejtave dhe diskriminimin e të huajve. Mund të telefononi në zyrë dhe të kërkoni këshilla, ose mund të shkoni personalisht atje. Megjithatë rezervoni gjithmonë kohë paraprakisht.

Vähemmistövaltuutettu

Työministeriö

Mikonkatu 4, kati 6

PL 34

00023 VALTIONEUVOSTO

tel. + 358 9 160 06 (qendra)

telefaks. + 358 9 160 47002

### **Zyra e këshillave juridike për refugjatë**

Avokatët e zyrës së këshillave juridike për refugjatë japin ndihmë legale dhe këshilla pa pagesë azilkërkuesve, refugjatëve dhe të huajve të tjerë. Para së gjithash, zyra e këshillave juridike për refugjatë ndihmon në çështjet lidhur me kërkimin e azilit, megjithatë mund të kërkoni këshilla edhe në çështje lidhur me pozitën legale të të huajit. Për tu takuar rezervoni gjithmonë kohë paraprakisht.

Mund të merrni këshilla edhe me telefon. Zyra e këshillave juridike për refugjatë ka zyra përveç në Helsinki edhe në Vaasa, Kouvola dhe në Oulu. Zyra qendrore gjendet në Helsinki:

Pakolasineuvonta ry

Varastokatu 12 B, 00580 Helsinki

Tel. (09) 2519 000, faks (09) 2519 0020

Posta elektronike: [pakneuv@kaapeli.fi](mailto:pakneuv@kaapeli.fi)

[www.pakolaisneuvonta.fi](http://www.pakolaisneuvonta.fi)

### **Avokatët privatë**

Në Finlandë ka avokatë të cilët janë të specializuar në trajtimin e çështjeve ligjore të emigrantëve. Zakonisht, shërbimet e avokatëve privatë janë të shtrenjta, por në disa raste shoqëria mund të kompensojë shpenzimet e procesit gjyqësor. Numërat kontaktuese të avokatëve privatë mund të gjehen prej numërorit telefonik.

Për informata të mëtejshme: [www.lakimiesliitto.fi](http://www.lakimiesliitto.fi)

### **Kërkimi ndërkombëtar i personit**

Mund të kërkoni ndihmën e Kryqit të Kuq të Finlandës (SPR) kur doni të gjeni anëtarë të humbur të familjes tuaj. Kërkimet fillohen duke kontaktuar zyrën qendrore të SPR:së. Gjithashtu kjo organizatë jep këshilla për azilkërkues dhe refugjatë si dhe ndjek nga afër zbatimin e sigurisë së të drejtave të tyre. Gjithashtu organizatat e inkuadruara në rrethin e SPR:së kanë shërbime për asistentë. Repartet e Kryqit të Kuq janë të hapur për të gjithë të itneresuarit.

Suomen Punainen Risti  
Tehtaankatu 1 a  
00140 Helsinki  
tel. (09) 129 31

### **Adresa internetore të dobishme**

[www.suomi.fi](http://www.suomi.fi)  
<http://virtual.finland.fi>  
[www.eduskunta.fi](http://www.eduskunta.fi)  
[www.vn.fi](http://www.vn.fi)  
[www.mol.fi](http://www.mol.fi)  
[www.stm.fi](http://www.stm.fi)  
[www.formin.fi](http://www.formin.fi)  
[www.oph.fi](http://www.oph.fi)  
[www.eurooppa-tiedotus.fi](http://www.eurooppa-tiedotus.fi)  
[www.kela.fi](http://www.kela.fi)  
<http://www.lib.hel.fi/mcl>  
[www.makupalat.fi](http://www.makupalat.fi)

Edita Prima Oy



Broshura është ripërpunuar nga:

Pirkko Jyväkorpä, Ministria e Punës  
Eeva-Liisa Niinioja, Enti i Sigurimit Shëndetësor dhe Pensionsal  
Ky botim gjendet në adresën: [www.mol.fi/migration/](http://www.mol.fi/migration/)  
Publikoi dhe financoi:  
Ministria e Punës, Enti i Sigurimit Shëndetësor dhe Pensionsal  
ISBN: 951-735-751-6  
Botimi i pestë i korrigjuar

Ilustrimi: Nick Fredriksson

Dizenjo dhe shtypja Editä Prima Oy, Helsinki 2003  
asiakaspalvelu.prima@edita.fi  
Tel. 020 450 011  
Faks. 020 450 2470  
Albania  
EDITA Oyj  
PL 800, 00043 EDITA, qendra 020 450 00  
Shërbimet për klientë  
Tel. 020 450 05, faks. 020 450 2380

Versionet e broshurës janë përkthyer në:

- finlandisht
- suedisht
- estonisht
- anglisht
- frëngjisht
- rusisht
- persisht
- gjuhën kurde
- arabisht

Versionet internetore:

[www.mol.fi/migration](http://www.mol.fi/migration)

- serbo-kroatisht
- somalisht
- shqip
- vietnamisht
- darisht

TM 7.902